

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË USHTRUAR NË DEGËN RAJONALE TË MJEDISIT DURRËS (DRM) “MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË, VLERËSIMI I VEPRIMTARISË EKONOMIKO FINANCIARE DHE MJEDISIT”.

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në ARM Durrës, me objekt “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar” për periudhën 01.01.2014 deri 31.12.2015 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 24, datë 30.03.2016. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën e KLSH me nr. 1208/5 datë 31.03.2016 “ Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse”, i janë dërguar znj. Kontjana Kuçi, me detyrë Drejtore e ARM Durrës, rekomandimet dhe zbatimi i masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje: Drejtoria Rajonale e Mjedisit (DRM) Qarku Durrës nuk ka hartuar e dërguar në Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) regjistrin kadastral mjedisor, dixhital elektronik për Qarkun, dokument i cili nëpërmjet shfrytëzimit të të dhënave konkrete të pasqyruara në lejet mjedisore, i shërben Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për marrjen e masave me qëllim që të evitohet ndotja dhe dëmtimi i mjedisit dhe përbërësve të tij, me synim rritjen e cilësisë së jetës të qytetarëve për këtë Qark (*trajtuar në faqet 13-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: DRM Qarkut Durrës, të hartojë dhe dërgojë në Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) regjistrin kadastral mjedisor, dixhital elektronik për Qarkun, nëpërmjet shfrytëzimit të të dhënave konkrete të pasqyruara në lejet mjedisore, dokument i cili nëpërmjet shfrytëzimit të të dhënave konkrete të pasqyruara në lejet mjedisore, i shërben Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për marrjen e masave me qëllim që të evitohet ndotja dhe dëmtimi i mjedisit dhe përbërësve të tij, me synim rritjen e cilësisë së jetës të qytetarëve për këtë Qark.

Menjëherë

2. Gjetje: DRM Qarkut Durrës, nuk ka hapur regjistër i cili të përmbajë të dhëna për veprimtaritë që gjenerojnë vajra të përdorura (lubrifikantë dhe ushqimorë), sasinë dhe llojin e tyre nga secila veprimtari në nivel Qarku, si dhe sasinë dhe llojin e vajrave të gjeneruara që janë çuar për përpunim (riciklim) e për asgjësim, në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe VKM Nr. 765, datë 7.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura” (*trajtuar në faqet 47-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: DRM Qarkut Durrës të krijojë një databazë, e cila të përditësohet me të dhënat nga subjektet përdorues dhe subjektet grumbullues të vajrave të përdorura, me sasinë dhe llojin e tyre, si dhe me të dhëna nga subjektet, të cilat kryejnë përpunimin (riciklimin) dhe asgjësimin e tyre, me synim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga pasojat e dëmshme të shkaktuara nga shkarkimet, depozitimi apo trajtimi i vajrave të përdorura.

Menjëherë

3. Gjetje: DRM Qarkut Durrës në kushtin e Lejes së Tipit C “Shkarkimet në kanalizime”, u konstatua se për sa i përket trajtimit të ujërave të ndotura që prodhohen nga veprimtaria e subjekteve, nuk janë përcaktuar teknikat, teknologjitë dhe metodat më të mira të mundshme

për trajtimin mjedisor të ujerave të ndotura dhe të përdorura, në përputhje me llojin e natyrën e tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujerave të ndotura”, i ndryshuar.

Rekomandim: DRM Qarku Durrës, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga ndikimet negative të ujerave të ndotura, të evidentojë subjektet, veprimtaria e të cilave shkaktojnë ndotje të ujerave mbi normat e lejuara si dhe të përcaktojë në kushtet e lejes së mjedisit të tipit C, mjedisin pritës ku do të derdhen ujërat e pastruara dhe regjimin e derdhjes së tyre (depuratorët e pastrimit përkatës), kërkesat për trajtimin mjedisor të llumrave, që rezultojnë nga trajtimi i ujerave të ndotura, në përputhje me natyrën, përbërjen dhe sasitë e tyre, mbajtjen e regjistrave si dhe kryerjen e monitorimit dhe publikimin e rezultateve të tij.

Në vazhdimësi

4. Gjetje: DRM Qarkut Durrës, për periudhën 2014 dhe 2015 nuk ka hapur librat e kontabilitetit për regjistrimin e shpenzimeve dhe klasifikimin e tyre sipas kapitujve, titujve, si ditarët analitik, libri i madh apo centralizatori. Për pasojë të gjitha veprimet janë kryer nga jashtë, veprim në kundërshtim me pikën 100 e 101 të kapitullit II. 3 “Buxhetit vendor” të UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” (*trajtuar në faqet 14-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: DRM Qarkut Durrës, specialistja e Financës të hapë librat e kontabilitetit dhe të kryejë regjistrimin e shpenzimeve sipas klasifikimit dhe sipas kapitujve, titujve, si dhe ditarët analitik, libri i madh apo centralizatori, në zbatim të pikës 100 e 101 të kapitullit II. të “Buxhetit vendor” të UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Menjëherë

5. Gjetje: Në DRM-në e Qarkut Durrës janë të regjistruar dhe disponojnë Leje Mjedisi të tipit A- 5 subjekte, Leje Mjedisi të Tipit B - 52 e subjekte dhe Leje Mjedisi të Tipit C-1067 subjekte (ku përfshihen dhe subjektet që janë të pajisur me autorizim mjedisor dhe Pëlqim Mjedisor).

Nga verifikimi i regjistrimit të evidentimit të autorizimeve të lëshuara për pagesën e tarifës vjetore nga operatorët e instalimit të tipit A, B dhe C dhe rakordimit që është bërë midis Ministrisë së Mjedisit dhe Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Durrës rezulton se kanë bërë pagesën e tarifës vjetore si më poshtë vijon:

- Për leje mjedisi të tipit A, 1 subjekt (1 x 10,000 lekë = 10,000 lekë)
- Për leje mjedisi të tipit B, 41 subjekte (41 x 5,000 lekë = 205,000 lekë)
- Për leje mjedisi të tipit C, 340 subjekte (340 x 2,000 lekë = 680,000 lekë)

Nga këto të dhëna rezulton se subjektet të cilët nuk kanë bërë pagesën e tarifës vjetore janë:

- Për leje mjedisi të tipit A, 4 subjekte në vlerën totale 40,000 lekë (4 x 10,000 lekë)
- Për leje mjedisi të tipit B, 11 subjekte në vlerën totale 55,000 lekë (11 x 5,000 lekë)
- Për leje mjedisi të tipit C, 657 subjekte në vlerën totale 1,314,000 lekë (657 x 2,000 lekë)

Sa më sipër ky institucion nuk ka arkëtuar tarifën vjetore nga 672 subjekte në shumën 1,409,000 lekë duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 417, datë 25.06.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit” (*trajtuar në faqet 18-22 të Raportit të Auditimit*).

Rekomandim: DRM Qarkut Durrës të marrë masa për saktësimin e adresave dhe të njoftojë 672 subjektet nga të cilët: 4 subjekte me Leje Mjedisi të tipit A, 11 subjekte me Leje Mjedisi të tipit B dhe 657 subjekte me Leje Mjedisi të Tipit C, të cilët nuk kanë bërë pagesën e tarifës vjetore sipas kërkesave ligjore të përcaktuara dhe në kushtet e Lejeve të Mjedisit.

DRM Qarku Durrës të marrë masa që subjektet të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë Qark dhe që janë të pajisur me Leje Mjedisi të Tipit (A, B dhe C) të paguajnë tarifën vjetore brenda 3-mujorit të parë të vitit.

Menjëherë

6. Gjetje: DRM Qarkut Durrës, për periudhën 2014 dhe 2015 rezulton se hyrjet dhe daljet e mallrave e materialeve të magazinës, nuk janë bërë sipas Regjistrit të aktiveve të njësisë të sektorit publik.

- Në asnjë rast nuk ka urdhër për daljen e materialeve nga magazina. Nuk ka të hapur librin e magazinës dhe kartelat e magazinës, veprime në kundërshtim me kapitullin e III-të, Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre, të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010. “Menaxhimin Financiar” pika 27, 38 dhe 40,b (trajtuar në faqet 21-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: DRM Qarkut Durrës dhe specialistja e Financës të marrin të gjitha masat që Hyrjet dhe daljet e mallrave e materialeve të magazinës të bëhen sipas Regjistrit të aktiveve të njësisë të sektorit publik, të hapet libri i magazinës dhe kartelat dhe çdo dalje e materialeve të shoqërohet me urdhër.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Gjetje: DRM Qarku Durrës, për vitin 2014 dhe 2015, nuk ka hartuar programin dhe nuk ka ndjekur hapat për ngritjen dhe instalimin e sistemit të MFK për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

- Nuk është ngritur struktura për të përcaktuar përgjegjshmërinë menaxheriale të punonjësve kryesorë bazuar në qëllimet strategjike dhe prioritetet e institucionit të DRM-së, si përcaktohet në nenet nr. 9, 10, 11 dhe 12 të ligjit dhe UMF nr. 54, datë 15.7.2010, “Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Nuk është hartuar program, nuk është organizuar sistemi, si dhe nuk janë përcaktuar procedurat standarde për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në këtë njësi publike.

- Nuk është ngritur grupi për menaxhimin strategjik, në zbatim të nenin 27/2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe nuk është çuar për trajnim pranë Ministrisë të Financës.

- Në asnjë rast nga AKM-ja dhe Ministria e Financave, nuk ka ardhur asnjë shkresë, “Për caktimin e nëpunësve autorizues në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, në zbatim të Urdhrit nr. 92, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, Udhëzimi nr. 28 datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm” të MFK (trajtuar në faqet 21-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: DRM Qarkut Durrës, të hartojë programin dhe të ndjekë hapat e duhur ligjor për ngritjen dhe instalimin e sistemit të MFK në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Të ngrihen strukturat për të përcaktuar përgjegjshmërinë menaxheriale të punonjësve kryesorë për qëllimet strategjike dhe prioritetet e institucionit të DRM-së, të përcaktohen procedurat standarde për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në këtë njësi publike. Të ngrihet grupi për menaxhimin strategjik, në zbatim të nenin 27/2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe nuk është çuar për trajnim pranë Ministrisë të Financës.

Menjëherë

8. Gjetje: DRM Qarkut Durrës, për vitin 2014 dhe 2015, nuk ka azhurnim dhe regjistrim të dokumentacionit të veprimeve kontabël, nuk ka ditarët analitik, nuk është mbajtur libri i madh, nuk ka ditar banke dhe nuk ka kontabilizim të llogarive.

Bilanci kontabël është nxjerrë, pa kryer veprimet e mbylljes në ditarin e veprimeve të ndryshme, në librin e madh, në ditarët analitik dhe nxjerrjen e llogarive e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor në fund të vitit, veprime në kundërshtim me kërkesat e

ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006, VKM nr. 248 datë 10.04.1998, të ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për miratimin e Planit Kontabël të Organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore e Lokale si dhe njësisve që varen prej tyre” dhe udhëzimit të MF nr. 14, datë 28.12.2006 ndryshuar me udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe mbylljen e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2013” (*trajtuar në faqet 26-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: DRM Qarkut Durrës, të bëjë azhurnimin dhe regjistrimin e dokumentacionit të veprimeve kontabël për vitin 2014 dhe 2015, duke mbajtur ditarët analitik, librin e madh, ditarin e bankës për të kryer kontabilizimin e llogarive. Bilanci kontabël të nxirret duke mbajtur dhe krahasuar me pasqyrat financiare vjetore të vitit ushtrimor në fund të vitit.

Menjëherë

9. Gjetje: DRM Qarkut Durrës, disponon një Rregullore të brendshme të institucionit e cila është e pa miratuar, pa protokoll dhe shkresë përcjellëse pra një draft Rregullore e dërguar elektronikisht (*trajtuar në faqet 19-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: - Titullari i institucionit t’i kërkojë AKM-së, për të legjitimuar dhe miratuar Rregulloren e Brendshme, e cila aktualisht është vetëm një draft Rregullore.

Menjëherë

10. Gjetje: DRM Qarkut Durrës sipas auditimit rezulton, se në dosjet e personelit, dokumentacioni i punonjësve është fotokopje dhe i pa noterizuar. Gjithashtu dosjet e personelit nuk janë të pajisura me inventar dhe të protokolluara mbi përmbajtjen e tyre në përputhje me ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, si dhe VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes dhe regjistrin të personelit” aneksi I dhe II (*trajtuar në faqet 19-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: DRM Qarkut Durrës, të marrë masat që të gjitha dosjet e personelit të plotësohen me dokumentacion origjinal apo fotokopje të noterizuara, duke bërë dhe inventarizimin e tyre.

Menjëherë

11. Gjetje: Njësia e Prokurimit e DRM Qarkut Durrës, nuk ka bërë përlllogaritje të fondit limit në asnjë rast. Fondi i prokuruar i referohet buxhetit të miratuar të institucionit. Në disa raste testimi i tregut është bërë pasi është përcaktuar fondi limit për objektin që do të prokurohet, duke mos bërë përlllogaritje e tij, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, kreu II, pika 2, germa ç, dhe VKM nr. 514, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu II, neni 9, pika 1 (*trajtuar në faqet 27-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Njësia e Prokurimit e blerjeve me vlera të vogla në DRM Qarkut Durrës, të marrë masa për përlllogaritjen e saktë të fondit limit, në përputhje me bazën ligjore të prokurimeve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

12. Gjetje: Në DRM Qarkut Durrës nuk është ngritur komision për kolaudimin dhe për marrjen e mallrave, punimeve dhe shërbimeve në dorëzim. Gjithashtu, në të gjitha procedurat e prokurimeve me vlera të vogla janë kryer likuidimet e mallrave dhe shërbimeve të prokuruar pa aktin e marrjes në dorëzim ose aktin që vërteton kryerjen e shërbimit. Nga ana tjetër janë kryer hyrjet në magazinë duke lëshuar fletë-hyrje pa patur një akt kolaudimi të mallit ose të marrjes në dorëzim nga punonjësja e cila është e ngarkuar në këtë detyrë, veprime në kundërshtim me pika 42, 43, 52 dhe 60, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011,

“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (trajtuar në faqet 27-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: DRM Qarkut Durrës, të marrë masa që çdo fillim viti dhe përgjatë tij, të ngrihet komision për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave, punëve apo shërbimeve në zbatim me pikat 42, 43, 52 dhe 60, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

13. Gjetje: DRM Qarkut Durrës, nuk ka marrëveshje të përbashkëta me organet e tjera të kontrollit, nuk janë hartuar programe kontrolli, plane pune dhe nuk janë kryer inspektime të përbashkëta, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, kreu II “Parimet e mbrojtjes së Mjedisit”, neni 11 “Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit”, pika 1 (trajtuar në faqet 57-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: DRM Qarkut Durrës të ndërmarrë masa për kryerjen e inspektimit e kontrolleve të përbashkëta, duke hartuar plane pune, programe kontrolli me organet e tjera të kontrollit në përputhje me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, kreu II “Parimet e mbrojtjes së Mjedisit”, neni 11 “Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit”, pika 1.

Menjëherë

14. Gjetje: Nga auditimi i kryer në lidhje me dhënien e mendimit nga ana e DRM-së Qarkut Durrës për subjektet që janë pajisur me Leje Mjedisi të Tipit A dhe B, 62 Raportet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis janë hartuar nga 13 Studio eksperte, dhe 9 subjekt fizike ekspert.

Për këto Raporte VNM-je kanë paraqitur faturat tatimore vetëm 18 subjekte dhe në 2 raste subjektet janë shprehur se nuk kanë faturë tatimore. Gjithashtu në 42 raste nuk është paraqitur faturë tatimore si nga ekspertët, studiot dhe subjektet (me gjithë njoftimin e marrë zyrtarisht). Në lidhje me këtë konstatim referuar sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr. 99/2015 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar (trajtuar në faqet 58-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: DRM Qarkut Durrës, në bashkëpunim me Drejtoritë Tatimore të Qarkut Durrës, t’i kërkojë të gjitha studiove dhe ekspertëve fizikë që kanë hartuar Raporte të VNM-së, të paraqesin një fotokopje të faturave tatimore dhe kuponit tatimor të këtij shërbimi.

DRM Qarkut Durrës gjatë shqyrtimit të dosjeve për dhënien e mendimit për subjektet që aplikojnë për tu pajisur me Leje Mjedisi të Tipit A dhe B, të kërkojë për çdo rast që bashkëngjitur Raportit të VNM-së të jetë fatura dhe kuponi tatimor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

15. Gjetje: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të aplikimit që janë shqyrtuar nga DRM Qarku Durrës për periudhën 2014 dhe 2015 konstatohet se, në dokumentacionin e subjekteve që iu është dhënë Akt Miratimi për Leje Tipi C rezultojnë mangësi si: përshkrimin e instalimeve të domosdoshëm për ushtrimin e aktivitetit i cili nuk është i plotë, nuk janë bashkëngjitur planet, skicat, hartat për ta përshkruar të gjithë aspektin e aktivitetit; mos deklarimin nga subjektet se si veprojnë me mbetjet e ngurta (llumrat e depozitave) që gjenerohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë; mungesën e koordinatave GAUS KRUGE; mungesën e dokumentit të pronësisë së tokës; mos deklarimi i informacioni në tabelat për shkarkimet e ujërave të ndotura, mbetjet e ngurta, përdorimi dhe prodhimi i energjisë, zhurmat dhe vibracionet sipas (tipit sasisë dhe burimit); mos plotësimi në mënyrë korrekte të

kodit kryesor të aktivitetit; veprime të cilat janë në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, Vendimit nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B Dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja" (trajtuar në faqet 31-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: DRM Qarku Durrës të marrë të gjitha masat për shqyrtimin në mënyrë objektive dhe korrekte të të gjitha kërkesave të subjekteve që kërkojnë të pajisen me Leje Mjedisit Tipi C, të plotësojnë formularin informues sipas kërkesave ligjore që janë në fuqi dhe të plotësojnë dosjen e aplikimit me të gjithë dokumentacionin përkatës dhe mbështetës në lidhje me aktivitetin që do të ushtrojnë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

16. Gjetje: Nisur nga arsyet e refuzimit të dhënies së lejes tipit C të paraqitura në Akt Refuzimet, ku DRM Qarku Durrës evidenton pasaktësitë dhe mangësitë në dokumentacionin përkatës të ardhur nga QKL-ja për subjektet që aplikojnë për Leje Tipi C, nga auditimi konstatohet se në dokumentacionin e subjekteve që iu është dhënë Akt Miratimi për Leje Tipi C, rezultojnë të njëjtat mangësi, duke bërë që për vendimet e marra në lidhje me shqyrtimin e dosjeve të përdoren standarde të dyfishta për plotësimin e dokumentacioneve, veprime këto në kundërshtim me kërkesat ligjore të Vendimit nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B Dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja (trajtuar në faqet 31-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: DRM Qarku Durrës, në shqyrtimin e Lejeve të Mjedisit të Tipit C të përdorë kushte dhe kërkesa të njëjta për plotësimin e informacionit të deklaruar nga ana e subjektit që aplikon për Leje Tipi C, të vendosë rregulla për dokumentacionin shtesë që subjektet duhet të kenë në dosjen e aplikimit gjë që të cilat do të vërtetojnë saktësinë e të dhënave që plotësohen në formularin informues pa bërë dallime dhe diferencime për plotësimin sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

17. Gjetje: DRM Qarku Durrës nuk ka përfshirë në kushtet e Lejes së Mjedisit të Tipit C për periudhën (gusht 2014 - nëntor 2014) detyrimin ligjor për taksën vjetore, duke vepruar kështu në kundërshtim me VKM nr. 417, datë 25.06.2014 "Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit" (trajtuar në faqet 31-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: DRM Qarku Durrës, të evidentojë të gjitha Lejet e Tipit C të dhëna në këtë periudhë (korrik-nëntor) dhe të njoftojë subjektet për përfshirjen e detyrimit ligjor që kanë për taksën vjetore sipas kërkesave të Vendimit nr. 417, datë 25.06.2014 "Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit".

Menjëherë

18. Gjetje: Nga auditimi konstatohet se nëse me legjislacionin e mëparshëm mjedisor, aktivitetet me ndikim të ulët (Autorizim Mjedisor) në mjedis ishin kategorizuar veçmas nga ato me ndikim të mesëm e të lartë (Leje Mjedisore), me legjislacionin e ri (aktual), të treja kategoritë e aktiviteteve A, B dhe C janë përfshirë në një Shtojcë të vetme dhe kategorizimi i aktiviteteve në A, B ose C bëhet në bazë të kapacitetit prodhues kufi të tyre, parametër që natyrisht nuk njihet dhe e bën të pamundur kategorizimin e aktiviteteve, nëse janë për Leje

mjedisi të tipit A, B ose C. Shpesh herë, emërtimi i aktiviteteve në Regjistrin e trashëguar të subjekteve me ndikim në mjedis nuk korrespondon me emërtimet e Shtojcës 1 të Ligjit nr. 10448 date 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar. Këto arsye e bëjnë të pamundur kategorizimin e veprimtarive në A, B apo C (trajtuar në faqet 47-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: DRM Qarku Durrës të bashkëpunojë me ISHMP Durrës për gjendjen aktuale të subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e tyre dhe që janë të pajisur me leje mjedisi tipi A, B, C, LM dhe AM, si dhe të verifikojnë çfarë aktiviteti kryen subjekti përkatës dhe nëse ky aktivitet bën pjesë në Shtojcën 1 të Ligjit nr. 10448 date 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar.

Vazhdimisht

19. Gjetje: Nga auditimi konstatohet se nga 858 subjekte që kanë detyrim ligjor për dorëzimin e raporteve të vetmonitorimeve deri në periudhën 30.6.2015, 119 subjekte të cilët e kanë detyrim ligjor për të sjellë një herë në tre muaj të dhënat e monitorimit mjedisor dhe 318 subjekte të cilët e kanë detyrim ligjor për të sjellë një herë në gjashtë muaj të dhënat e monitorimit mjedisor, nuk kanë sjellë pranë DRM Durrës informacionin periodik mjedisor, duke vepruar kështu në kundërshtim me kushtet e vendosura në Lejen e Mjedisit apo të Autorizimit Mjedisor dhe Vendimit nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja” (trajtuar në faqet 47-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: DRM Durrës dhe Specialisti i Monitorimeve të marrin masat e duhura për të njoftuar subjektet në lidhje me vetmonitorimet e përcaktuara në kushtet e Lejes Mjedisore si dhe të rrisin bashkëpunimin institucional për koordinimin dhe për realizimin e detyrave për të cilët këto institucione janë përgjegjës, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

Menjëherë

20. Gjetje: Nga auditimi i kryer konstatohet se në mbajtjen e regjistrit të shkarkimeve dhe të transferimeve, për vitin 2014, vihen re shumë mangësi në plotësimin dhe përditësimin me të dhëna të ardhura nga raportet e vetmonitorimeve, si kusht ligjor në lejet e miratuara nga DRM Qarku Durrës. Format i regjistrit të shkarkimeve të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, nuk është plotësuar me të dhënat e duhura, mungon data e dorëzimit të raporteve të vetmonitorimit, veprime këto në kundërshtim me kushtet e vendosura referuar Vendimit nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja” si dhe rregullores së brendshme të institucioni (trajtuar në faqet 47-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: DRM Qarku Durrës, Specialisti i monitorimeve, në përputhje me kërkesat dhe detyrat e përcaktuara nga kuadri rregullator, të marrë masa për plotësimin e regjistrit të shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve në mënyrë korrekte, në mënyrë që të kemi një situatë të gjendjes së mjedisit me të dhënat e shkarkimeve në tokë, ujë dhe ajër.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Rekomandim: DRM Qarkut Durrës, të kryejë kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e arkëtimit të tarifës vjetore që rezulton e pa paguar nga 672 subjekte **në shumën 1,409,000 lekë** si më poshtë:

- 4 subjekte që disponojnë lejen e mjedisit të tipit A, në vlerën totale 40,000 lekë
- 11 subjekte që disponojnë lejen e mjedisit të tipit B, në vlerën totale 55,000 lekë
- 657 subjekte, që disponojnë lejen e mjedisit të tipit C në vlerën totale 1,314,000 lekë.

Sipas aneksit nr. 3 bashkëlidhur (*trajtuar në faqet 17-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Për Kompetencë të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

C 1. Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, nenit 57 si dhe nenit 59 të ligjit , gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, mbështetur dhe në ligjit nr.

10431, datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, neni 6, 7, 8, 9 dhe 14 “Parimet e Mbrojtjes së Mjedisit”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit: Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësive për mangësitë dhe shkeljet për secilin punonjës, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të filloi procedurat për dhënien e masave disiplinore:

-Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga detyra” në bazë të analizës për rezultatet e auditimit të paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit në DRM Durrës për:

a. z. ██████████, me detyrë Drejtore e DRM-në Qarku Durrës për arsye se:

- Për vitin 2014 dhe 2015, nuk ka hartuar program për ngritjen e sistemit të MFK për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

- Nuk ka ngritur struktura për të përcaktuar përgjegjshmërinë menaxheriale të punonjësve kryesorë bazuar në qëllimet strategjike dhe prioritetet e institucionit të DRM-së, si përcaktohet në nenet nr. 9, 10,11 dhe 12 të ligjit dhe UMF nr. 54, datë 15.7.2010, “Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Nuk ka hartuar program, nuk është organizuar sistemi, si dhe nuk janë përcaktuar procedurat standarde për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në këtë njësi publike.

- Nuk është ngritur grupi për menaxhimin strategjik, në zbatim të nenin 27/2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe nuk është çuar për trajnim pranë Ministrisë të Financës.

- Në asnjë rast nga AKM-ja dhe Ministria e Financave, nuk ka ardhur asnjë shkresë, “Për caktimin e nëpunësve autorizues në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, në zbatim të, Urdhri nr. 92, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, Udhëzimi nr. 28 datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm” të MF.

- DRM-ja Durrës, nuk ka saktësuar adresat e plota dhe nuk ka njoftuar 672 subjekte për të paguar tarifën vjetore në shumën 1,409,000 lekë. Nga të dhënat rezulton se subjektet të cilët nuk kanë bërë pagesën e tarifës vjetore janë:

- Për leje mjedisi të tipit A, 4 subjekte në vlerën totale 40,000 lekë (4 x 10,000 lekë)

- Për leje mjedisi të tipit B, 11 subjekte në vlerën totale 55,000 lekë (11 x 5,000 lekë)

- Për leje mjedisi të tipit C, 657 subjekte në vlerën totale 1,314,000 lekë (657 x 2,000 lekë)

- Nuk ka marrëveshje të përbashkëta me organet e tjera të kontrollit, nuk janë hartuar programe kontrolli, plane pune dhe nuk janë kryer inspektive të përbashkëta, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", kreu II "Parimet e mbrojtjes së Mjedisit", neni 11 "Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit", pika 1.

- Nuk ka ngritur komision për të mbajtur aktin e kolaudimit dhe marrjen e mallrave, punimeve dhe shërbimeve në dorëzim.

- Në dokumentacionin e subjekteve që kanë aplikuar për t'u pajisur me Leje Mjedisit C edhe pse rezultojnë mangësi si: përshkrimin e instalimeve të domosdoshëm për ushtrimin e aktivitetit, bashkëngjitja e planeve, skicave, hartave për ta përshkruar të gjithë aspektin e aktivitetit; mos deklarimin nga subjektet se si veprojnë me mbetjet e ngurta (llumrat e depozitave) që gjenerohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë; mungesën e koordinatave GAUS KRUGE; mungesën e dokumentit të pronësisë së tokës; mos deklarimi i informacioni në tabelat për shkarkimet e ujërave të ndotura, mbetjet e ngurta, përdorimi dhe prodhimi i energjisë, zhurmat dhe vibracionet sipas (tipit sasisë dhe burimit); mos plotësimi në mënyrë korrekte të kodit kryesor të aktivitetit, iu është dhënë Akt Miratimi për Leje Tipi C duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, Vendimit nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B Dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja".

- Nisur nga arsyet e refuzimit të dhënies së lejes tipit C të paraqitura në Akt Refuzimet, ku DRM Durrës evidenton pasaktësitë dhe mangësitë në dokumentacionin përkatës të ardhur nga QKL-ja për subjektet që aplikojnë për Leje Tipi C, nga auditimi konstatohet se në dokumentacionin e subjekteve që iu është dhënë Akt Miratimi për Leje Tipi C, rezultojnë të njëjtat mangësi, duke bërë që për vendimet e marra në lidhje me shqyrtimin e dosjeve të përdoren standarde të dyfishta për plotësimin e dokumentacioneve, veprime këto në kundërshtim me kërkesat ligjore referuar Vendimit nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B Dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja.

- Nuk ka përfshirë në kushtet e Lejes së Mjedisit të Tipit C për periudhën (gusht 2014 - nëntor 2014) detyrimin ligjor për taksën vjetore, duke vepruar kështu në kundërshtim me VKM nr. 417, datë 25.06.2014 "Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit".

- Në mbajtjen e regjistrit të shkarkimeve dhe të transferimeve, për vitin 2014, vihen re shumë mangësi në plotësimin dhe përditësimin me të dhëna të ardhura nga raportet e vetmonitorimeve, si kusht ligjor në lejet e miratuara nga DRM Qarku Durrës. Format i regjistrit të shkarkimeve të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, nuk është plotësuar me të dhënat e duhura, mungon data e dorëzimit të raporteve të vetmonitorimit, veprime këto që janë në kundërshtim me kushtet e vendosura referuar Vendimit nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive

të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja” si dhe rregullores së brendshme të institucionit.

C 2. Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, nenit 57 si dhe nenit 59 të ligjit, gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, do të kërkonim të fillonin procedurat për dhënien e masës disiplinore:

Nga “Vërejtje” deri në “Mbajtja 1/3 e pagës së plotë për një periudhë tre mujore” për:

a. znj. [REDAKTUAR], me detyrë specialiste e Zyrës të Financës dhe

b. znj. [REDAKTUAR], me detyrë specialiste e Zyrës të Financës nga data 02.05.2015, për arsye se:

- Referuar konstatimit rezulton, se për të dy vitet, nga ana e specialisteve të financës nuk janë hapur librat për regjistrimin e shpenzimeve dhe klasifikimin e tyre sipas kapitujve, titujve, si ditaret analitik, libri i madh apo centralizatori, Të gjitha veprimet janë kryer nga jashtë. Veprim në kundërshtim me pikën 100 e 101 të kapitullit II. 3 “Buxhetit vendor” të UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- nuk kanë bërë azhurnimin dhe regjistrimin të dokumentacionit të veprimeve kontabël, nuk kanë hapur ditaret analitik, nuk ka mbajtur librin e madh, nuk ka ditar banke nuk ka kontabilizim të llogarive.

- Bilanci kontabël është nxjerrë, pa kryer veprimet e mbylljes në ditarin e veprimeve të ndryshme, në librin e madh, në ditaret analitik dhe nxjerrjen e llogarive e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor në fund të vitit. Veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”, ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006, VKM nr. 248 datë 10.04.1998, të ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për miratimin e Planit Kontabël të Organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore e Lokale si dhe njësisive që varen prej tyre” dhe udhëzimit të MF nr. 14, datë 28.12.2006 ndryshuar me udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe mbylljen e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2013”.

- Zyra e financës, në të gjitha procedurat e prokurimeve me vlera të vogla ka kryer likuidimet e mallrave dhe shërbimeve të prokuruar pa aktin e marrjes në dorëzim ose aktin që vërteton kryerjen e shërbimit. Veprime në kundërshtim me pika 42, 43, 52 dhe 60, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- DRM-ja Durrës, nuk ka saktësuar adresat e plota dhe nuk ka njoftuar 672 subjekte për të paguar tarifën vjetore në shumën 1,409,000 lekë. Nga të dhënat rezulton se subjektet të cilët nuk kanë bërë pagesën e tarifës vjetore janë:

- Për leje mjedisi të tipit A, 4 subjekte në vlerën totale 40,000 lekë (4 x 10,000 lekë)

- Për leje mjedisi të tipit B, 11 subjekte në vlerën totale 55,000 lekë (11 x 5,000 lekë)

- Për leje mjedisi të tipit C, 657 subjekte në vlerën totale 1,314,000 lekë (657 x 2,000 lekë)

c. znj. [REDAKTUAR], me detyrë specialiste Mjedisi dhe magazinierë, për arsye se:

- Hyrjet dhe daljet e mallrave e materialeve të magazinës, nuk i ka bërë sipas Regjistrit të aktiveve të njësisë të sektorit publik.

- Për daljen e materialeve nga magazina në asnjë rast nuk ka urdhër.

- Nuk ka të hapur librin e magazinës dhe kartelat e magazinës. Veprime në kundërshtim me kapitullin e III-te, Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre, të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010. “Menaxhimin Financiar” pika 27,38 dhe 40.

- Ka kryer hyrjet në magazinë duke lëshuar fletë-hyrje pa patur një akt kolaudimi të mallit ose të marrjes në dorëzim nga punonjësja e cila ka përsipër këtë detyrë. Veprime në kundërshtim me pika 42, 43, 52 dhe 60, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Për kompetencë DRM Durrës.

C 3. Mbështetur në nenin 58 "llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", nenit 57, nenit 59 të ligjit, gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", si dhe ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", i rekomandojmë Titullarit direkt të filloj procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Vërejtje" neni 58, gërma a për:

a. znj. [REDACTED]

b. znj. [REDACTED]

c. znj. [REDACTED]

d. znj. [REDACTED]

e. z. [REDACTED]

f. znj. [REDACTED]

me detyrë specialist leje dhe VNM dhe në cilësinë e anëtarëve të shqyrtimit të lejeve për vitin 2014-2015, për arsye se:

- Në dokumentacionin e subjekteve që iu është dhënë Akt Miratimi për Leje Tipi C rezultojnë mangësi si: përshkrimin e instalimeve të domosdoshëm për ushtrimin e aktivitetit i cili nuk është i plotë, nuk janë bashkëngjitur planet, skicat, hartat për ta përshkruar të gjithë aspektin e aktivitetit; mos deklarimin nga subjektet se si veprojnë me mbetjet e ngurta (llumrat e depozitave) që gjenerohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë; mungesën e koordinatave GAUS KRUGE; mungesën e dokumentit të pronësisë së tokës; mos deklarimi i informacioni në tabelat për shkarkimet e ujërave të ndotura, mbetjet e ngurta, përdorimi dhe prodhimi i energjisë, zhurmat dhe vibracionet sipas (tipit sasisë dhe burimit); mos plotësimi në mënyrë korrekte të kodit kryesor të aktivitetit; veprime të cilat janë në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, Vendimit nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B Dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja".

- Nisur nga arsyet e refuzimit të dhënies së lejes tipit C të paraqitura në Akt Refuzimet, ku DRM Durrës evidenton pasaktësitë dhe mangësitë në dokumentacionin përkatës të ardhur nga QKL-ja për subjektet që aplikojnë për Leje Tipi C, nga auditimi konstatohet se në dokumentacionin e subjekteve që iu është dhënë Akt Miratimi për Leje Tipi C, rezultojnë të njëjtat mangësi, duke bërë që për vendimet e marra në lidhje me shqyrtimin e dosjeve të përdoren standarde të dyfishta për plotësimin e dokumentacioneve, veprime këto në kundërshtim me kërkesat ligjore referuar Vendimit nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B Dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja.

- Nuk kanë përdorur kushte dhe kërkesa të njëjta për shqyrtimin e dokumentacionit dhe formularit të aplikimit të deklaruar nga ana e subjektit që aplikon për Leje Mjedisi Tipi C.

g. z. ████████, me detyrë specialist Monitorimi dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit teknik për vitin 2014

- Në dokumentacionin e subjekteve që iu është dhënë Akt Miratimi për Leje Tipi C rezultojnë mangësi si: përshkrimin e instalimeve të domosdoshëm për ushtrimin e aktivitetit i cili nuk është i plotë, nuk janë bashkëngjitur planet, skicat, hartat për ta përshkruar të gjithë aspektin e aktivitetit; mos deklarimin nga subjektet se si veprojnë me mbetjet e ngurta (llumrat e depozitave) që gjenerohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë; mungesën e koordinatave GAUS KRUGE; mungesën e dokumentit të pronësisë së tokës; mos deklarimi i informacioni në tabelat për shkarkimet e ujërave të ndotura, mbetjet e ngurta, përdorimi dhe prodhimi i energjisë, zhurmat dhe vibracionet sipas (tipit sasisë dhe burimit); mos plotësimi në mënyrë korrekte të kodit kryesor të aktivitetit; veprime të cilat janë në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, Vendimit nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B Dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja".

- Nisur nga arsyet e refuzimit të dhënies së lejes tipit C të paraqitura në Akt Refuzimet, ku DRM Durrës evidenton pasaktësitë dhe mangësitë në dokumentacionin përkatës të ardhur nga QKL-ja për subjektet që aplikojnë për Leje Tipi C, nga auditimi konstatohet se në dokumentacionin e subjekteve që iu është dhënë Akt Miratimi për Leje Tipi C, rezultojnë të njëjtat mangësi, duke bërë që për vendimet e marra në lidhje me shqyrtimin e dosjeve të përdoren standarde të dyfishta për plotësimin e dokumentacioneve, veprime këto në kundërshtim me kërkesat ligjore referuar Vendimit nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B Dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja.

-Nuk kanë përdorur kushte dhe kërkesa të njëjta për plotësimin e informacionit të deklaruar nga ana e subjektit që aplikon për Leje Mjedisit Tipi C.

-Në mbajtjen e regjistrin të shkarkimeve dhe të transferimeve për vitin 2014 ka pasur mangësi në plotësimin dhe përditësimin me të dhënat e ardhura nga raportet e vetmonitorimit, si kusht ligjor në lejet e miratuara.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Piro Imeraj, Erion Muho, Genta Brahja dhe Sazan Guri, më tej u shqyrtua nga k/auditues Selfo Zeneli, Drejtori i Departamentit Alush Zaçe, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT